

M A R S

2 0 2 0

MONITORIMI I AKTIVITETIT FILANTROPIK
SHQIPËRIA

EDICION
SPECIAL



M O N I T O R I M I I
A K T I V I T E T I T F I L A N T R O P I K
g j a t ë
S I T U A T Ë S C O V I D - 1 9

MARS 2020

Partnerët Shqipëri po kryen monitorimin e aktivitetit filantropik në Shqipëri nëpërmjet hulumtimit të medias, përfshi edhe ato sociale, si dhe burimeve të informacionit nga institucionet publike dhe jo-publike. Hulumtimi kryhet mbi baza ditore dhe gjetjet paraqesin çështjet e mbështetura, natyrën e dhurimeve, si dhe natyrën e dhuruesve. Nëpërmjet këtij Edicioni Special Partnerët Shqipëri prezanton raste mbi monitorimin e këtij aktiviteti gjatë situatës së COVID-19 në Shqipëri.

Filantropi në kohë të karantinës

SITUATA AKTUALE
31 Mars 2020

243

Raste

13

Viktima

52

Shëruar

Prej disa mujash po përballemi me një krizë globale shëndetësore të shkaktuar nga koronavirus COVID-19. Situata aktuale është tepër e vështirë dhe e paprecedentë, e për fat të keq dimë ende shumë pak rreth këtij virusi. Deri në 31 Mars 2020, llogariten më shumë se 88,000 të prekur në të gjithë botën.

Menaxhimi dhe frenimi i kësaj pandemie ka qënë dhe vazdon të jetë një sfidë tejet e vështirë që i ka kushtuar jetën shumë personave, përfshirë këtu dhe personelin mjekësor që ka qënë në frontin e parë. Si pasojë, për të frenuar përhapjen e COVID-19 dhe menaxhimin ekonomik, shëndetësor dhe social të pasojave të krijuara nga përhapja e tij, vende në nivel botëror kanë marrë një seri masash të karakterit social por edhe ekonomik.

Kjo fatkeqësi na bën të kuptojmë se ne jemi të ndërruarur dhe kemi nevojë për njëri-tjetrin!

Pavarësisht vështirësive të shumta solidariteti njerëzor nuk ka munguar. Krahas organizatave të ndryshme që janë aktivizuar për tu ardhur në ndihmë njerëzve në nevojë, vëmendja dhe mirënjohja më e madhe shkon për personelin mjekësor, i cili vazhdon të shërbejë me përkushtim dhe vetmohim duke qenë i rrezikuar në adresimin në vijë të parë të këtij virusi. Kështu, përpos punës së tyre të palodhur për të përballuar situatën e krijuar në vend, rreth 30 mjek nga Shqipëria u nisën për tu ardhur në ndihmë kolëgëve italian, të goditur rëndë nga ky virus.

Ky gjest human pati një jehonë ndërkombëtare dhe u përshëndet nga personalitete të ndryshme të botës politike apo artistike. Një shprehje e ndjerë e këtij falenderimi ishte edhe nga një flautist italian, i cili në shenjë mirënjohje luajti himnin kombëtar shqipëtar në mediat italiane.

Fqinji ynë, Italia, ka qënë vendi më i prekur nga pandemia, e shprehje solidariteti erdhën si nga institucionet në vend ashtu edhe nga qytetarët shqipëtarë. E tillë ishte edhe shfaqja e flamurit tricolor në një seri fasdash në institucionet si: Teatri Petro Marko në Vlorë, Presidenca e Shqipërisë, Kulla e Sahatit në Elbasan, apo dhe në muret e kështjellës së Argjirosë në Gjirokastër.



Pasi mjekët italianë u shfaqën në një video ku shprehnin shqetësimin dhe dëshpërimin e tyre si rezultat i mungesës së paisjeve të ventilimit, njerëz të shumtë në të gjithë botën filluan të kërkonin zgjidhje inovatore, alternative dhe të shpejta.

Dy laborantë dentarë në Tiranë arritën të prodhonin përmes një printeri 3D një pajisje përshtatëse, e cila mundëson dyfishimin e kapacitetit të ventilatorëve në luftën kundër COVID-19. Ata deklaruan se u ishte ofruar ndihmë edhe nga kolegët në Kosovë. Gjithashtu dy arkitekte Dea Buza dhe Albano Guma, në zyrën e tyre të arkitekturës prodhuan maska mbrojtëse për stafin mjekësor të QSUT-së e më pas të Spitalit të Shkodrës, me printera 3D dhe shpenzimet e tyre. Nismës së tyre iu bashkua dhe studio "3D Army".

Një tjetër iniciativë është platforma on-line "HEROI IM" ku të gjithë personat që dëshirojnë të ofrojnë ndihmë mund të regjistrohen. Kjo platformë synon të krijojë një rrjet vullnetarësh, për të asistuar personelit shëndetësor dhe familjet të tyre.

MILANO PËR SHQIPËRINË

www.milanomedical.eu/al

#nejemimeju

Milano Medical

Pas dërgimit të 30 mjekëve e infermierëve shqiptarë në Itali, mjekët shqiptarë që jetojnë dhe punojnë atje, ofruan një mbështetje për popullatën shqiptare në këto ditë të vështira duke ofruar këshilla, rekomandime, informacione apo konsulta nëpërmjet platformës online "Milano për Shqipërinë". Ky projekt i inspiruar nga Dr. Altin Palloshi u përqafua edhe nga mjekë të tjerë të cilët japin kontributin e tyre jo vetëm në Itali, por edhe në vende të tjera të Evropës.




Për të ndihmuar në përmirësimin e infrastrukturës spitalore me pajisje kryesisht aspiratorë, është krijuar fushata crowdfunding “Covid-19: Help Albanian hospital buy ventilators”. Kjo është një iniciativë e zotit Argon Shehaj, e cila synon të grumbullojë fonde për blerjen e disa aspiratorëve për spitalin e Sanatoriumit.

Gjithashtu INDIVIDË të ndryshëm kanë dhënë ndihmën e tyre në përballimin e krizës. Biznesmeni Alban Kardashi i cili zotëron një studio grafike, prodhoi rreth 70 mburoja për fytyrën falas për personelin mjekësor të spitalit të Durrësit dhe rreth 100 të tilla për personelin e spitalit rajonal të Fierit. Ndërkohë këtij spitali i janë dhuruar edhe 90 palë këpucë sanitare, donacion i një fasonerie në Krujë.

Anila Lici, një rrobaqepëse nga qyteti i Elbasanit, vendosi që profesionin e saj ta përdorë në kuadër të një kauze të mirë për të ndihmuar ata që janë më të rrezikuarit nga CoVid-19 si policët apo mjekët duke kontribuar në qepjen dhe shpërndarjen e më tepër se 500 maskave.

Krahas ndihmave në prodhimin e pajisjeve mjeksore apo gjetjeve e zgjidhjeve inovatore në këtë drejtim, mirënjohja kundrejt mjekëve është shprehur gjithashtu në forma simbolike apo artistike. Nisma e emisionit Hipokrati ftoi të gjithë familjet në Tiranë e kudo, të dilnin nëpër ballkonet e tyre për të përshëndetur me duartrokitje përgjatë 15 minutave mjekët dhe infermierët në luftën e tyre kundër koronavirusit.

Një nismë e ngjashme u ndërmor edhe nga Zyra e Bashkimit European në Tiranë e cila gjithashtu ftoi qytetarët shqiptarë të dalin në dritare për të duartrokitur në formë mbështetje ata që janë në vijën e parë të luftës ndaj koronavirusit, mjekët, infermierët, sanitarët, zjarrfikësit, policët etj.



ORGANIZATAT e SHOQËRISË CIVILE janë angazhuar në përballimin e situatës që prej fillimit. Dy nga fondacionet më të rëndësishme në vend si 'Fundjavë Ndryshe' apo 'Firdeus' kanë qenë pranë njerëzve në nevojë duke shpërndarë me mijëra pako me ushqime dhe duke adresuar nevojat bazike në të gjithë vendin në koordinim me Ministrinë e Mbrojtjes. Këtyre fondacioneve u janë bashkuar në këtë mision shumë biznese që kanë dhënë ndihmën e tyre si: "Kosmonte Foods AI", "Eurolab Internacional Grup shpk", "Balfin Group", etj.

Një grup organizatash të shoqërisë civile dhe profesionistësh u organizuan në një platformë virtuale 'Më mirë së bashku' për ofrimin e informacionit dhe shërbimeve ndaj familjeve dhe individëve në nevojë, të izoluar si pasojë e masave të marra kundër pandemisë së koronavirusit.


Ekipi i Nismës "Dhuro një lule për Sarandën" bashkë me Saranda Web kanë ndarë rreth 80 pako ushqimore (të blera me kontribute të aktivistëve). Ekipi ka nisur fushatën në gofundme për ata që mund të ndihmojnë me kontribute sipas mundësive. Një organizatë tjetër që iu gjend pranë familjeve në nevojë me paketa ushqimore dhe higjieno-sanitare është dhe Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS. Instituti SME Albania që mbështet sipërmarrësit e vegjël dhe të mesëm bëri një donacion me ndihma ushqimore për rreth 250 familje në qytetin e Tepelenës.

Një ndihmesë të madhe kanë dhënë dhe BIZNESET.

Mund të përmendim Vodafonë Albania, e cila për të lehtësuar sadopak nxënësit dhe maturantët, ofroi falas platformën School Me, ku të rinjtë kanë mundësinë të marrin mësim dhe leksione në formë audio-vizuale. Laboratori virtual i Inovacionit – ICTSlab përbën gjithashtu një mundësi shumë optimale për ndjekur kurset dhe klasat virtuale që ky aplikacion ofron.

Gjithashtu grupi i biznesmenëve durrsakë, të cilët dhuruan rreth 200 bukë çdo ditë për shtresat në nevojë. Në Gjirokastrë një biznes i vogël, i cili u mbyll gjatë karantinës preferoi që mallrat e dyqanit të shpërndajë për shtresat në nevojë. Ekipi i prodhimit të 'Krienko Jeans' iu përgjigj nevojës për maska me një çmim ekonomik për publikun dhe 50% të tyre vendosi tua dhurojë personelit shëndetësor dhe mjeksor.

Një nismë shumë e ndjerë ka qënë "Adopto një gjysh e një gjyshe!". Kësaj nisme iu bashkua një zonjë e moshuar 83-vjeçare, e cila dhuroi penionin e saj në ndihmë të pensionistëve të vetmuar dhe familjeve në nevojë. Nisma u kërkoi të gjithë atyre që marrin leje për të dalë në fashën e orarit të ndihmonin pensionistët apo familjet në nevojë që jetojnë pranë tyre. Zonja Hatixhe provoi se heronjtë e vërtetë janë njerëz sikundër ajo, të cilët u vijnë në ndihmë të tjerëve me një bujari e vetmohim që duhet të jetë një shëmbull për të gjithë.



Shqiptarët që jetojnë jashtë territorit të Shqipërisë kanë dëshmuar në këtë kohë disa vlera të spikatura të popullit shqiptar sikudër janë bujaria dhe solidariteti. Ata kanë dhënë një shëmbull tejet pozitiv dhe inspirues në vendet në të cilat punojnë dhe jetojnë, duke shfaqur një kujdes dhe ndihmesë të posaçme kundrejt komuniteteve ku bëjnë pjesë . Një nga këto raste është një grua me emrin Hatixhe Hallulli e cila dhuron gjithmonë, edhe gjatë vitit, torta dhe fokace për personelin e Ndhmës së Shpejtë së Fiorenzuolës të cilat i bën në shtëpi. Ajo ka vijuar të mbështesë personelin mjeksor të provincës të Piacenzës në detyrën e tyre të vështirë e plot sakrificë. Gjesti i saj ka ngrohur zemrat e personelit që nuk ka hezitur ta falenderojë publikisht.

Nga bota e artit një shqiptar tjetër frymëzues është Adrian Pacin, një piktor i njohur shqiptar që jeton në Milano. Adriani iu bashkua një nisme dashamirëse, ku së bashku me artistë të tjerë vendosën të dhurojnë veprat e tyre për të financuar spitalet italiane në nevojë.

Elona Agalliu, një vajzë nga Korça që jeton në Greqi bëri një gjest human duke qepur 600 maska dhe duke ua dhuruar falas spitalit Grevena në Greqi. Ky gjest i shqiptares i ka bërë përshtypje edhe presidentes së Greqisë, Katerina Sakellarapoulou, e cila e përmendi atë në një status që ka bërë në "Facebook".

D I A S P O R A

Edmond Prenga është një shqiptar, pronar i një furre buke në Romë. Ai ndërmori një nismë humane duke ofruar bukë falas për cilindo që ka nevojë. Ai tregoi me anë të këtij veprimi mirënjohjen ndaj Italisë që e mirëpriti dhe i dha mundësinë e një jete të re. Shëmbullin e tij e ndoqën edhe shumë biznese të tjera.

Shqiptarët në Trieste u bënë bashkë dhe shpërndanë dhjetëra pako për njerëzit në nevojë. Gjesti i tyre tërheqi vëmendjen e një qytetari italian, i cili përmes një videoje që është bërë virale dhe në rrjetet sociale, u shpreh i mahnitur nga ky solidaritet.

Federata Shqiptare e Futbollit (FSHF) nisi një fushatë me qëllim motivimin e fëmijëve gjatë periudhës së karantinimit kombëtar. FSHF-ja lançoi në kanalet sociale këtë fushatë, që u kërkonte fëmijëve të rrinë në shtëpi dhe të luajnë futboll sipas kushteve tona familjare. Për 20 videot më të mira do të akordohen çmime të ndryshme.

Disa prej emrave më të njohur të artit shqiptar u bënë një dhuratë shpirtërore shqiptarëve në formën e një kolazhi muzikor nën tingujt e këngës “Shqipëri o vendi im” në ditët e vështira të izolimit për shkak të karantinës . Gjithashtu dhe instrumentistët shqiptarë kanë ofruar një spektakël në kuadër të nismës së Ministrisë së Kulturës ‘Unë qëndroj në shtëpi’. Instrumentistë nga qytete të ndryshme të Shqipërisë iu bashkuan kësaj nisme.

Një nismë tjetër e artisëve shqiptarë nën hashtagun #mebluzatebardha, ishte performimi i një kënge në formën e një kolazhi si dhuratë mirënjohjeje për bluzat e bardha.

Vëmendje i është kushtuar edhe leximit. Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit shpalli konkursin “Libri i karantinës”, i cili ftoi për të marrë pjesë gjithë autorët shqiptarë kudo që ndodhen. Ky konkurs që do të vazhdojë deri në 15 maj, vepra më e mirë e këtij konkursi do të botohet nga QKLL.

Festivali i filmit dhe dokumentarit “Dokufest” iu bashkua komunitetit ndërkombëtar të filmit me metrazh të shkurtër në festivalin online “My darling Quarantine”, i cili synon të grumbullojë të ardhura për personat e prekur nga Koronavirusi si dhe për ata që po ndihmojnë në luftën kundër këtij virusi nëpërmjet një fushate në gofundme.



F i l a n t r o p i n ë k o h ë t ë k a r a n t i n ë s

Fatmirësisht kurba e përhapjes së infektiveve është në ulje dhe jemi shpresëplotë për tju rikthyer normalitetit së shpejti. Sigurisht që bota që do të gjejmë do të jetë krejt ndryshe nga ajo që lamë dhe pasojat do të ndihen gjatë. Është në dorën tonë sidoqoftë të nxjerrim mësimet e dhura nga kjo provë dhe ti gjindemi më pranë njeri tjetrit duke vlerësuar jetën, shëndetin si dhe përditshmërinë tonë. Por më e rëndësishmja duke zhvilluar ndjenjën e solidaritetit dhe lënien mënjane të individualizimit që shoqëronë shoqërinë tonë.



Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim
www.partnersalbania.org

#Rrinështëpi